



Republika e Kosovës
Republika Kosovo -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Seancë plenare e Kuvendit
P- 71/11
Prishtinë, më 28 maj 2009
Ndërtesa e Kuvendit, salla e seancave plenare.

PROCESVERBAL

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË MBAJTUR
MË 28 MAJ 2009**

Seancën e kryesoi Xhavit Haliti, kurse i ndihmoi Eqrem Kryeziu, anëtar i Kryesisë së Kuvendit.

Kryesuesi konstatoi se në seancë janë të pranishëm 91 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare, në pajtim me rregullat 6.2 dhe 23 të Rregullores së Punës së Kuvendit, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Kryesuesi i njoftoi deputetët se sipas marrëveshjes dhe Vendimit të Grupit Parlamentar “7+” është bërë ndërrimi i anëtarit të Kryesisë së Kuvendit nga radhët e komunitetit joshqiptar dhe joserb, si dhe ndërrimi i kryetarit të këtij Grupi Parlamentar , si vijon:

1. Deputetja Myfera Shinik do të jetë anëtare e Kryesisë së Kuvendit, kurse
2. Deputeti Xhezair Murati, caktohet kryetar i Grupit Parlamentar “7+”.

Gjithashtu, Grupit Parlamentar i AAK-së propozon zëvendësimin e një anëtari në komision parlamentar, përkatësisht deputeti Haki Shatri caktohet anëtar i Komisionit për Buxhet dhe Financa në vend të deputetit Xhevdet Neziraj.

Ne fillim të seancës, për fjalë u paraqitën këta deputetë:

Ministri i Administratës Publike të Kosovës, **Arsim Bajrami**, propozoi që pika 4, 5 dhe 6 të shtyhen për seancën tjetër të radhës.

Ministri për Komunitete dhe Kthim, **Sasha Rashiq**, propozoi që pika 7 e rendit të ditës të shtyhet për seancën e radhës.

Kryetari i Grupit Parlamentar të LDK-së, **Lutfi Haziri** propozoi që pika e 3 e propozuar të shtyhet për seancën tjetër të radhës.

Kryearti ftoi deputetët që me ngritje dore të deklarohen për propozimet e dhëna më lart.

Kuvendi, me shumicë absolute, miratoi propozimet e cekuar më lart për heqjen e pikave nga rendi i ditës.

Kryesuesi i njoftoi deputetët se në pajtim me Rregullën 23.2 të Rregullores së Punës, Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 26 maj 2009 vendosi që Kuvendit t'i propozojë për seancën e sotme plenare të radhitet edhe – Shqyrtimi i parë i Projektligjit për anëtarësimin e Republikës së Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe në Organizatat e Grupit të Bankës Botërore.

Kryesuesi i ftoi deputetët që me ngritje dore të deklarohen për propozimin e Kryesisë, të mbështetur edhe nga Komisioni për Buxhet dhe Financa.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë absolute, miratoi propozimin që në rend dite të përfshihet edhe shqyrtimi i parë i Projektligjit për anëtarësimin e Republikës së Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe në Organizatat e Grupit të Bankës Botërore.

Në vazhdim, Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

R e n d d i t e

1. Miratimi i procesverbaleve të seancave plenare, të mbajtura më 14, 15 e 22, maj 2009,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Shqyrtimi i Raportit të Rregullatorit për Ujëra e Mbeturina,
4. Debat lidhur me procesin e privatizimit, sipas kërkesës së një grupi të deputetëve,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për anëtarësimin e Republikës së Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe në Organizatat e Grupit të Bankës Botërore.

1. Miratimi i procesverbaleve të seancave plenare, të mbajtura më 14,15 e 22 maj 2009

Kryesuesi njoftoi deputetët se për shkak të shtyrjes së njëpasnjëshme të seancës plenare të datës 14 maj 2009, do të miratohet vetëm Procesverbali i seancës plenare të mbajtur më 15 maj 2009, i cili u është shpërndarë deputetëve.

Kryesuesi pyeti deputetët se a kanë vërejtje në procesverbal?

Deputeti Shkumbim Demaliaj pati vërejtje në procedurat e emërimit të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Deputeti Riza Smaka tha se emërimi i gjyqtarëve në Gjykatën Kushtetuese është bërë në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Kuvendi miratoi Procesverbalin e seancës plenare të mbajtur më 15 maj 2009, me vërejtjet e dhëna.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputetja, Myrvete Pantina, parashtoi pyetje për ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Mahir Yagcilar, lidhur me kontaminimin e ujërave nënëtoksor në zonën e KEK-ut.

Për shkak të mungesës së ministrit Yagcilar, Deputetja Pantina nuk mori përgjigje.

Deputeti, Driton Tali, parashtoi pyetje për Kryeministrin, Hashim Thaçi, lidhur me sekretaret dhe kryeshefat ekzekutiv që janë ushtrues detyre më shumë se gjashtë muaj.

Kryeministri Thaçi iu përgjigj pyetjes së deputetit Tali.

Deputeti, Naser Rugova, parashtoi pyetje për ministrin e Punëve të Brendshme, Zenun Pajaziti, lidhur me qytetaret në mërgatë për pajisjen me karta dhe dokumente të identifikimit në përfaqësitë diplomatike të vendit tonë.

Për shkak të mungesës së ministrit Pajaziti, Deputeti Rugova nuk mori përgjigje.

Deputeti, Shkumbin Demaliaj, parashtoi pyetje për zv/kryeministrin, Hajredin Kuçi, lidhur me vizitën e presidentit të Serbisë në Kosovë.

Kryeministri Thaçi iu përgjigj pyetjes së deputetit Demaliaj.

Deputetja, Myfera Shinik, i parashtoi pyetje ministrit të Administratës Publike të Kosovës, Arsim Bajrami, lidhur me mbishkrimin e shenjave në gjuhët zyrtare në komuna.

Ministri Bajrami iu përgjigj pyetjes së deputetes Shinik.

Deputeti, Enis Kervan, i parashtoi pyetje ministrit të Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë, Enver Hoxhaj, lidhur me nostrifikimin e diplomave nga Universiteti i Turqisë.

Ministri Hoxhaj iu përgjigj pyetjes së deputetit Kervan.

Deputetja, Sanije Aliaj, parashtroi pyetje për Kryeministrin, Hashim Thaçi, lidhur me rekomandimet e Komisionit për punë dhe Mirëqenie Sociale.

Për shkak të mungesës së Kryeministrit Thaçi, deputetja Aliaj nuk mori përgjigje.

Deputetja, Myrvete Pantina, i parashtroi pyetje ministrit të Bujqësisë, Pylltarisë dhe zhvillimit Rural, Idriz Vehapi, lidhur me hapësirat bujqësore të planifikuara për mbjellje.

Ministri Vehapi iu përgjigj pyetjes së deputetes Pantina.

Deputetja, Njomëza Emini, i parashtroi pyetje ministrit të Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë, Enver Hoxhaj, lidhur me standardet e teksteve shkollore.

Ministri Hoxhaj iu përgjigj pyetjes së deputetes Emini.

Deputetja, Sanije Aliaj, parashtroi pyetje për Kryeministrin, Hashim Thaçi, lidhur me rekomandimet e Komisionit për Punë dhe Mirëqenie Sociale.

Për shkak të mungesës së Kryeministrit Thaçi, deputetja Aliaj nuk mori përgjigje.

Deputeti, Xhevdet Neziraj, parashtroi pyetje për ministrin e Komuniteteve dhe të Kthimit, Nenad Rashiq, lidhur me kthimin e komunitetit egjiptas nga Gjermania.

Ministri Rashiq iu përgjigj pyetjes së deputetit Neziraj.

Deputetja, Luljeta Shehu, i parashtroi pyetje ministrit të Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë, Enver Hoxhaj, lidhur me ekskursionin e maturantëve të gjimnazit “Gjon Buzuku”.

Ministri Hoxhaj iu përgjigj pyetjes së deputetes Shehu.

3. Shqyrtimi i Raportit të Rregullatorit për Ujëra dhe Mbeturina

Kryesuesi njoftoi deputetët me rekomandimet e Komisionit parlamentar për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim, Rural dhe Planifikim Hapësinor, i cili ka shqyrtuar Raportin e Rregullatorit për Ujëra dhe Mbeturina për vitin 2008 dhe Kuvendit i ka rekomanduar shqyrtimin e tij në seancë plenare.

Në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, Gani Koci tha se Komisioni ka shqyrtuar këtë raport dhe Kuvendit i rekomandon që atë ta miratojë.

Kryesuesi hapi debatin lidhur me Raportin e Rregullatorit për Ujëra dhe Mbeturina.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë raport dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Elheme Hetemi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Armend Zemaj, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së Eset Cakolli, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së,

Naim Maloku, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, Xhezair Murati, në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, Mursel Halili, në emër të Grupit Parlamentar “Zajedno”, Vezira Emrush, si dhe deputetët: Myrvete Pantina, Ibrahim Makolli, Lutfi Haziri, që janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverballi.

Kryesuesi e hodhi në votim miratimin e këtij raporti. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për81,
Kundër..... 0,
Abstenime..... 2.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Raportin e Rregulltarit për Ujëra dhe Mbeturina.

4. Debat lidhur me procesin e privatizimit, sipas kërkesës së një grupi të deputetëve

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e grupit të deputetëve ta marrë fjalën.

Deputeti **Arsim Rexhepi** tha se kërkesën time e kanë mbështetur edhe një numër i konsiderueshëm i deputetëve.

Kemi kërkuar që në debat të marrë pjesë edhe ministri i Ekonomisë dhe Financave, z. Ahmet Shala dhe Dino Hasanaj, nga Agjencioni Kosovar i Privatizimit.

Deputeti **Emrush Xhemajli** tha se informata e Agjencionit Kosovar të Privatizimit, që u është shpërndarë deputetëve, nuk është e saktë.

Deputeti **Lutfi Haziri** tha se nëse Kuvendi nuk ka mundësi të sjellë sot personat e kërkuar për debat, atëherë debati duhet të caktohet për një kohë tjetër.

Deputeti **Shkumbin Demaliaj** e përkrahu propozimin e deputetit Lutfi Haziri dhe çështja e Agjencionit të Privatizimit të rregullohet me ligj.

Kryesuesi dha pauzë.

Pas pauzës, propozuesi i mocionit, deputeti **Arsim Rexhepi** tha se kërkesa ka për qëllim zbardhjen e mekanizmit tjetërsues të pasurisë së vendit tonë, e cila me djersë dhe mund është krijuar. Ky mocion synon të kërkojë të vërtetën e shumë kërkuar nga të gjithë qytetarët e këtij vendi. Si janë tjetërsuar e privatizuar, nga kush, kur, në çfarë kushtesh njësitë ekonomike të Kosovës, si po funksionojnë ato tani, a i kanë përmbushur kushtet e kontratave të privatizimit dhe, po ashtu, si po vazhdojnë të privatizohen njësitë e tjera ekonomike të Kosovës.

Ai theksoi se ky raport s’thotë asgjë tjetër veç se ne nuk dimë çka ka ndodhur para nesh, ne nuk kemi fakte se çka kanë bërë ata para nesh, ne nuk kemi ide se ç’është bërë me privatizimin, të tjerët e kanë gozhdur ekonominë e Kosovës. Procedurat e privatizimit të të mirave ekonomike të popullit të Kosovës kanë qenë të zhvilluara larg nga veshi dhe syri i qytetarit të Kosovës, shumë nga njësitë e privatizuara shënojnë procedura të pakëndshme dhe jo transparente, kontrata e privatizimit të Ferronikelit është aq e dëmshme për ekonominë kosovare, sa vetëm nga shfrytëzimi i tarifave speciale të furnizimit me energji, ekonomia kosovare dëmtohet për çdo vit me miliona euro.

Ai theksoi se, ndotja e ambientit në një rreze prej 50 kilometrash katrorë nga tymtarët e kësaj fabrike është aq e madhe dhe e rrezikshme për jetën e banorëve dhe të trevave përreth, sa që pasojat do të jenë të paimagjinueshme. Në prag janë privatizimet e mëdha: KEK-u, PTK-ja, Aeroporti e kështu me radhë. Për të fokusuar interesimet tona në këtë proces jetik, ne duhet të japim kontributin tonë.

Kryesuesi hapi debatin lidhur me procesin e privatizimit.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë raport dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Lutfi Haziri, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së Behxhet Pacolli, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Naim Maloku, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Berim Ramosaj, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, Sadik Idriz, në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, Bojan Stojanoviq, në emër të Grupit Parlamentar “Zajedno”, Vezira Emrush, si dhe deputetët: Naim Rustemi, Naser Rugova, Agim Veliu, Gani Geci, Myzejene Selmani, Hashim Thaçi, Arsim Rexhepi, Ibrahim Makolli, Armend Zemaj, Ardian Gjini, Riza Smaka, Ibrahim Gashi, Myrvete Pantina, Kaqusha Jashari, Ismet Beqiri, Sanije Aliaj, Xhylnaze Sylja, Gani Buqinca dhe Ministri i Ekonomisë dhe Financave, z. Ahmet Shala, që janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverbal.

Në fund, në emër të parashtruesit të mocionit, **Arsim Rexhepi**, përmbylli debatin duke konstatuar se qëllimi i këtij debati ka qenë për ta ngritur një çështje, e cila na brengos të gjithëve lidhur me fatin e ndërmarrjeve të privatizuara. Shpresoj që ky debat nuk do të jetë i fundit për këtë çështje. Ne, si Kuvend duhet të ushtrojmë kontroll parlamentar mbi segmente të caktuara të qeverisjes.

Kryesuesi, në mungesë të kuorumit, shtyu punimet e seancës për ditën e nesërme.

E premte, 29 maj 2009
Vazhdimi i seancës

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për anëtarësimin e Republikës së Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe në organizatat e Grupit të Bankës Botërore

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë së Kosovës që ta prezantojë Projektligjin për anëtarësimin e Republikës së Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe në organizatat e Grupit të Bankës Botërore.

Ministri Ahmet Shala tha se para se të prezantojë Ligjin për anëtarësimin e Republikës së Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe në Grupin e Bankës Botërore, fillimisht do t’ju informoj rreth procesit të anëtarësimit të vendit tonë në këto dy institucione shumë të rëndësishme financiare botërore.

Ai theksoi se Kryeministri i Republikës së Kosovës ka bërë aplikim formal më 10 korrik të vitit të kaluar për anëtarësim të Republikës së Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe në Grupin e Institucioneve të Bankës Botërore. Menjëherë pas atij aplikimi, ne kemi formuar një grup punues në përbërje të Kryeministrit, Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave për të udhëhequr dhe proceduar këtë proces dhe në tetor të vitit të

kaluar për herë të parë Kosova u ftua nga këto dy organizma për të marrë pjesë në takime vjetore të Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe të Bankës Botërore.

Ai theksoi se pas krijimit të komisionit për përcaktim të kuotës dhe të anëtarësimit nga ana e Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe pas aprovimit të kuotës, procesi i votimit kishte filluar në prill dhe ka mbaruar më 5 maj. Gjatë kësaj kohe, në koordinim me të gjithë partnerët tanë strategjik ndërkombëtarë, konsideroj se kemi arritur që Kosovën ta shtymë një hap përpara në këtë drejtim.

Ministri Shala tha se kjo ftesë Kosovës i është bërë pas një rezultati shumë të mirë nga votimi i të gjithë guvernatorëve të Fondit Monetar Ndërkombëtar, ku siç jeni të informuar, 138 vende e përkrahën Kosovën për t'u bërë anëtare e plotë me të drejta të plota të këtij institucioni të rëndësishëm, prej të cilave 96 shtete e votuan "për" 10 "kundër" dhe 32 abstenuan, por të gjitha këto e mbështetën Kosovën për të qenë anëtare e Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe besoj e lus që të gjitha ta bëjnë këtë edhe për anëtarësim në Bankën Botërore. Me këtë rast dua që në emër të juaj, në emër të Republikës së Kosovës t'i falënderoj të gjithë ata miq ndërkombëtarë dhe të gjitha këto shtete që po na mbështesin në procese të rëndësishme të integritetit ndërkombëtar.

Ai theksoi se parimisht, me aprovimin e këtij ligji pranohen të gjitha obligimet dhe përgjegjësitë, si dhe benificionet që mund t'i ketë Kosova pas anëtarësimit në këto institucione të rëndësishme ndërkombëtare.

Ministri Shala kërkoi nga deputetet që në procedurë të përshpejtuar ta aprovojnë këtë ligj dhe ne të jemi në gjendje që anëtarësimin e Republikës së Kosovës në këto dy institucione ndërkombëtare të rëndësishme ta përmbyllim me sukses në qershor.

Kryesuesi, në emër të deputetëve përshëndeti z. **Age Baker**, drejtor ekzekutiv i grupit të shteteve të Fondit Monetar Ndërkombëtar që udhëhiqet nga Holanda, i cili ishte prezent në sallë duke përcjellë miratimin e ligjit.

Kryesuesi hapi debatin lidhur me këtë projektligj.

Në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, Gani Koci tha se ka qenë mendimi unanim që ky projektligj të përkrahet dhe të miratohet, në parim, por duke pasur parasysh nevojën dhe domosdoshmërinë që angazhimet e Qeverisë së Kosovës të fuqizohen pikërisht edhe nga Kuvendi lidhur me këtë Projektligj dhe anëtarësimin në Fondin Monetar Ndërkombëtar, ne mendojmë se duhet të respektohet kërkesa e Qeverisë për të zënë afatet, siç i paraqiti edhe ministri.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Ramë Buja, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Lutfi Haziri, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Ibrahim Makolli, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Haki Shatri, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Synavere Rysha, në emër të Grupit Parlamentar "7+", Myfera Shinik, në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, Radmilla Vujoviq, si dhe deputetët: Shkumbin Demaliaj, Driton Tali dhe Gani Koci, të cilat janë bashkangjitur në transkript.

Kryesuesi hodhi në votim propozimin e Qeverisë që ky projektligj të shqyrtohet dhe të miratohet me procedurë të përshpejtuar.

Kuvendi, me shumicë absolute, miratoi propozimin për shqyrtimin dhe miratimin e këtij projektligji me procedurë të përshpejtuar.

Pastaj, kryesuesi hodhi në votim miratimin e këtij projektligji, në parim. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----79,
Kundër-----0,
Abstenime-----2.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi në parim Projektligjin për anëtarësimin në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe në organizatat e Grupit të Bankës Botërore.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Buxhet dhe Financa, si komision funksional dhe raportues, Komisionit për Legjislacion, Gjyqësi, Komisionin për Komunitete dhe Komisionin për Integritet Evropian, që ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda afatit sa më të shpejtë të mundshëm dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

Kryesuesi e deklaroi të mbyllur seancën në orën 11:10 minuta.

Kryetari i Kuvendit,
Jakup KRASNIQI

Përgatiti: **Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale**